



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.606/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi, kryesues, Kymete Kicaj dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhavit Drenorit, Kryetar I.Q “GREEN për Drenas”, kandidat për kryetar në komunën e Drenasit, paraqitur kundër Ramiz Lladrovci, kandidat për Kryetar të Komunës së Drenasit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, për shkak të mos shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të hapësirave publike për promovimin e materialeve propagandistike, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e palejuar ankesa Anr.606/2021 e datës 01.10.2021, e paraqitur nga Xhavit Drenorit, Kryetar I.Q “GREEN për Drenas”, ndaj Ramiz Lladrovci, kandidat për Kryetar të Komunës së Drenasit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2021, Xhavit Drenori, Kryetar I.Q “GREEN për Drenas, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se Komuna e Drenasit ka nxjerrë një vendim me të cilën iu është ndaluar vendosja e posterëve promovues nëpër vende dhe objekte publike, e cila iu kishte mbetur si mundësia e vetme për promovimin nëpër bilborde të cilat janë të shpërndara në disa lokacione në Komunën e Drenasit e të cilat menaxhohen nga një operator ekonomik privat. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se ka kontaktuar me përfaqësuesin e operatorit ekonomik “Prestige Media” për të kërkuar hapësirën për promovim të posterit të subjektit të tyre, duke bërë pagesën sipas tarifave të saj. I njëjti shtoi se në ditën kur ka filluar fushata zgjedhore zyrtarisht me një email iu kishte drejtuar zyrës për Informim me kërkesën që sa i përket shfrytëzimit të zonave publike të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë kandidatët të cilët marrin pjesë në garën për kryetar të komunës së Drenasit.

Sipas parashtruesit të ankesës më datë 15.09.2021, një ditë para fillimit të fushatës, Kryetari aktual i komunës së Drenasit, z. Lladrovci, kishte nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik N.T.SH “Prestige Media”, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Drenasit, pa kompensim dhe se i njëjti të nesërmen kishte vendosur në të gjitha hapësirat vetëm posterat e kandidatit për kryetar komune të Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili aktualisht ka postin e kryetarit të kësaj komune.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP, që të siguroj një garë te drejtë dhe të barabartë, pa diskriminim dhe me mundësi të njëjtë të promovimit të kandidatëve për kryetar të komunës, si dhe programet e tyre.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë kontratën me numër 400bl-46335 e datës 15.09.2021, Kërkesë për hapësirën promovuese në hapësirën publike komunale, komunikimet me email si dhe 8 (tetë) imazhe të posterëve të vendosur në hapësirat promovuese.

PZAP-i me datën 01.09.2021 ka dërguar subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 02.10.2021 deri në ora 14:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2021, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se Komuna e Drenasit ka lidhur kontratë për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit, ashtu siç parasheh Rregullorja Nr.09-2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe komuna nuk ka asnjë kompetencë që të vendos për ato hapësira publike, përderisa ajo kontratë është në fuqi nga kompania N.T.SH "Prestige Media". Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se kandidati për kryetar të komunës së Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka kërkuar nga ana e kompanisë së lartcekur që t'i ketë në shfrytëzim billbordet sipas tarifës së përcaktuar nga kjo kompani, duke e bërë edhe pagesën e faturës së lëshuar nga kompania dhe kjo faturë iu është bashkangjitur përgjigjes në ankesë. Në vazhdim theksohet se pasi është bërë rezervimi me kohë dhe pagesa për shfrytëzimin e tyre sipas tarifës së përcaktuar nga ana e kompanisë e cila është plotësisht e pavarur të vendos se kujt t'i jap në shfrytëzim këto hapësirat dhe nuk kanë të bëjnë me diskriminimin, monopol apo të ngjashme dhe kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), që ankesën të hedhë si të pabazuar.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur Faturën e lëshura nga N.T.SH "Prestige Media", fletëpagesën, rregulloren Nr.12-400/01-5554, të datës 26.11.2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren komunale Nr.12-400-16587, e datës 27.05.2020 për Ndryshim Plotësim për Taksa, tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës vlerësoj se ankesa është **e palejuar**, për këto arsye:

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitur në PZAP nga Xhavit Drenori, Kryetar I.Q "GREEN për Drenas me të cilën pretendon se iu është bërë e padrejtë dhe janë diskriminuar nga komuna dhe kompania në fjalë për shfrytëzimin e barabartë të hapësirës së dedikuar për reklamim gjatë fushatës, parashtruesi nuk ka legjitimitet për të paraqitur ankesa të tilla, sepse në bazë të Rregullores zgjedhore 13/2013, Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike, neni 3 *materialet e shtypura të fushatës së zgjedhjeve*,

Neni 3.7 përcakton se, KKZ-të duhet që aktivisht ta monitorojnë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materialeve të tjera të zgjedhjeve të subjekteve politike të certifikuar gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve. Në rast të shkeljes së Kodit të Sjelljes për Zgjedhjet ose të dispozitave të përcaktuara me Rregullat e Zgjedhjeve të KQZ-së ose Ligjit në Fuqi, KKZ-të duhet që menjëherë ta informojnë subjektin politik në fjalë që të marr masa korrigjuese. Nëse shkeljet përsëriten nga i njëjti subjekt politik ose i njëjti refuzon që ti korrigjoj shkeljet e identifikuar KKZ-ja, duhet ta raportoj rastin në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresat (PZAP).

Andaj paneli konsideron se kjo ankesë është hedhur e palejuar pasi që nuk është kompetencën e Kryetarit të subjektit politik, në rastin konkret Xhavit Drenori, Kryetar I.Q “GREEN për Drenas që të parashtroj ankesë lidhur me ndarjen e barabartë për shfrytëzimin e hapsirave të dedikuara për billborde. Mirëpo sipas vlerësimit të PZAP-së, mbetet në diskrecionin e KQZ-së-KKZ e Drenasit të monitoroj shfrytëzimin e materialeve të shtypura dhe çfarëdo materiale të tjera të subjekteve të certifikuar që marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë që të mos bëhet shkelja e legjislacionit zgjedhor në fuqi dhe në rast se ndodhin këto shkelje nga këto subjekte politike KKZ të raportoj PZAP-në, sepse nuk është arsye për shkak të lëshimeve nga monitorimi i KKZ-së, të bëhet mos shfrytëzimi i barabartë i hapësirave nga kandidatët për kryetar të Komunës së Drenasit.

Për këto arsye Paneli si dhe nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2015 të PZAP-it, nenin 6 paragrafi 4, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 606/2021, më datën 04.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.